REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 133/17
Date/Datum. 19.06.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEÈ

PSH. Nr. 133/17

PANELI SHQYRTUES, i emëruar në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, si dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin nr.04/L-237, me ligjin nr.05/L-068 dhe me ligjin 05/L-92, në përbërje prej z.Tefik Sylejmani - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi – Referues, z. Blerim Dina – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE NTSH "Ekoinvest" - Prishtinë, kundër autoritetit kontraktues/ "Korporata Energjetike e Kosovës" sha, lidhur me aktivitetin e prokurimit, për tenderin me titull: "Furnizim me platformë transportuese", me nr. të Prokurimit: KEKO 16 399 11,të iniciuar nga autoriteti kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës me dt. 09.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik NTSH "Ekoinvest" - Prishtinë, nr. 133/17, parashtruar kundër autoritetit kontraktues/ Korporata Energjetike e Kosovës, sha, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me platformë transportuese", me nr. të Prokurimit: KEKO 16 399 11.

II. **Anulohet,** vendimi i Autoritetit Kontraktues / Korporata Energjetike e Kosovës- sha, për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me platformë transportuese", me nr. të Prokurimit: KEKO 16 399 11.

III. **Obligohet,** Autoritetit Kontraktues / Korporata Energjetike e Kosovës, sha, që aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me platformë transportuese", me nr. të Prokurimit: KEKO 16 399 11, ta kthej në **ri- vlerësim**.

IV. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me ketë prokurim .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk

respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj.

V. Operatorit ekonomik ankues NTSH "Ekoinvest", i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës, megjithatë obligohet i njejti që në afat prej më së largu gjashtëdhjetë (60) ditësh të paraqes kërkesë për kthim të mjeteve - sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

AK- korporata energjetike e Kosovë ka bërë njoftimin për kontratë me dt.08.12.2016 procedurë e hapur,kontratë për furnizime vlerë të madhe,afati i fundit për ofertim ka qenë dt.03.02.2017 dhe po të njëjtën ditë është bërë hapja e tyre.

Për këtë aktivitet të prokurimit kan aplikuar 4 OE.

Kriter për dhënie të kontratës AK është përcaktuar për kriterin tenderi i përgjegjshëm me qmim më të ulët.AK ka formuar komisionin në përbërje prej 5 anëtarëve me qëllim të vlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve dhe për kontratë kanë rekomanduar OE "Thyssenkrup Industrial Solution"AG nga Gjermania.

Njoftimin për dhënie të kontratës AK e ka bërë me dt.20.04.2017.

Operatori Ekonomik NTSH "Ekoinvest", Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP me dt: **08.05.2017**, me Nr. **133/17**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës , duke pretenduar se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së ne fuqi , siç janë:

- Neni - 7, 10, 11 dhe 59 të LPP-së, si dhe neni 18 dhe 39, të rregullave të UOPP-së.

Ankesa aprovohet si e bazuar

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së ne fuqi, më datën 22.05.2017, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar - trajtuar pretendimet ankimore të përfshira ne ankese, te OE NTSH "Ekoinvest" – Prishtinë. Sipas nenit 114, të LPP-se eksperti shqyrtues më datën 30.05.2017, dorëzon raportin, me sqarimet ndaj pretendimeve ankimore të përfshira në ankesë, rrjedhimisht panelit shqyrtues i ka propozuar qe ky aktivitet i prokurimit të ri-vlerësohet, ndërsa ankesa e OE NTSH "Ekoinvest" të aprovohet si e bazuar.

AK - Korporata Energjetike e Kosovës, sha, përmes parashtresës me shkrim te datës 02.06.2017, njofton panelin shqyrtues se te njëjtit nuk pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues.

OE NTSH "Ekoinvest", po ashtu përmes parashtresës me shkrim te datës 02.06.2017 njofton panelin shqyrtues se te njëjtit pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës: **09.06.2017**, në të cilën ishin prezent anëtarët e Panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues, përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit, i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave,

raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues.

Fillimisht fjala i'u kalua përfaqësuesit të OE: NTSH "Ekoinvest". avokatit z. Rrecaj i cili deklaroj: "Në emër të OE ankues nuk kam të shtoj më shumë ne qëndrojmë në tërësi pranë pretendimeve ankimore të cilat janë kofnrimuar nga eksperti shqyrtues për shkelje të LPP-së, të numëruara si në ankesë. LPP është shumë i qartë, se nuk është vendimtar çmimi më i ulët që një tenderi t'i jepet një operatori ekonomik, mirëpo vetëm nëse operatori ekonomik është i përgjegjshëm. Në këtë rast shkeljet janë aq të rënda ashtu që operatori ekonomik fitues është dashtë të shpallej i papërgjegjshëm, andaj i propozojmë panelit të aprovohet ankesas sipas rekomandimit të ekspertit shqyrtues dhe lënda të shkoj në rivlerësim".

Përfaqësuesi i AK-KEK z.Fazliu deklaroj: "Si përfaqësuesi i AK-KEK, nuk pajtohemi me mendimin dhe sqarimet e ekspertit dhe qëndrojmë fuqimisht pranë analizës dhe përgjigjes që kemi dhënë në kërkesën për rishqyrtim. Po nisem prej pikës pretenduese të OE ankues për qasje në dokumentacion, ne i kemi lejuar qasje në versionin e pastruar kofnrom nenit 11 të LPP-së , ku pa prejudikuar detyrimet për ti siguruar palëve qasje, si dhe nenin 7.5 të UOPP-së që ka të bëjë me informata sekrete që duhet t'i plotësoj OE, ku i njëjti ka nënshkruar kërkesën për konfidencialitet dhe për kufizimin e qasjes në dokumentacioni i cili ka të bëjë me nenin 68 të LPP dhe nenin 69 të LPP-së.

OE ankues ka pas qasje të pakufizuar në dokumentacionin e kualifikuar si dokumentacion për qasje. Te formulari tenderit, në cilën ankuesi "Ekoinvest" thirret, analiza e ekspertit është e pasaktë sepse OE fitues ka prezantuar komplet pjesën C, të formularit të tenderit, pjesa parë ku plotësohet çmimi total, dhe pjesa tjetër në rastin konkret ku është rubrika e nënshkrimit dhe vulës i ka vendos, dhe është e pabaza konstatimi ekspertit pasi nuk mundet OE të shpikë fletë tabela për nënshkrim. Pjesa e parë e formularit përbëhet prej 9 pikëve, në faqen e dytë të formularit të lëshuar nga KRPP, "Tyssen" e ka plotësuar siq kërkohet në dosje, dhe faqja e dytë është vazhdimësi e faqes së parë.

Po ashtu pjesa dytë e pjesës C, përshkrimi i çmimeve e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Pra nuk është e drejtë nga eksperti që i sqaron këto faqe se janë të ndara nga njëra tjera por janë pjesë formularit. Pretendimi tjerët se OE i rekomanduar në pikën 7 ku kërkohet vendosja numrit loteve OE nuk ka bërë asnjë shkelje, sepse çfarëdo lloj vërejtje e OE apo shënimi në atë pjesë është jo relevante. OE i rekomanduar për kontratë pozicionet 3, 4 dhe 5 i ka përfshirë në artikullin 1, dhe ka potencuar se janë të përfshira në artikullin. Në rast se do kishte dhënë çmim zero, OE do duhej kërkuar sqarime, mirëpo në rastin konkret ka theksuar se pocionet 3, 4, 5 janë të përfshira në pozicionin 1. OE i rekomanduar ka plotësuar dhe ka respektuar në tërësi dosjen e tenderit., andaj ne qëndrojmë pranë vendimit të AK-së".

Eksperti shqyrtues z. Bibaj deklaroj: "Në cilësi të ekspertit sipas nenin 113 të LPP kam trajtuar dhe sqaruar pretendimet ankimore dhe kam përshkrua në raport, megjithatë po përsërisë, shkurtimisht pretendimet atë me formularin e tenderit pjesa C, pjese e OE të rekomanduar për kontratë. I njëjti formular nuk përmban të dhënat siç kërkohet me nenin 18 par.3 i rregullave të UOPP-së legjislacion sekondar i KRPP, është e vërtet se formulari përmban dy pjesë, mirëpo pjesa e parë nuk është e nënshkruar apo e vulosur nga i njëjti ofertues. Sipas përshkrimit rezulton të jete nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes dhe

të vlerësimit. Sipas këtij paragrafi OE do duhej të plotësoj dhe nënshkruaj dy pjesët e formularit. Për më tepër pika 7, e njëjtit formular ku dedikohet për ofrim pjesës ose lotit, është përshkruar një numër i cili nuk korespodon me numrin e këtij aktiviteti, përkundër faktit që ky aktivitet nuk ka qenë i ndarë në lote.

Pretendimi tjetër ka të bëjë me pozicionet e paramasës. AK, ka përshkruar gjithsej 6 pozicione, ndërsa pozicioni 3, 4 dhe 5, pjesë e ofertës së OE të rekomanduar, nuk ka të përshkruar çmim fare por është përshkruar se të njëjtat pozicione janë të përfshira në pozicioni 1. Po ashtu edhe këtë pretendim e kam kualifikuar si të bazuar, duke u mbështet në nenin 39.8 të UOPP-së, forma tabelave sqaron rastet e tilla. Po ashtu e njëjta sqarohet në edhe tek ueb faqja e KRPP-së, tek pyetjet e shpeshta, ku thuhet se nëse OE nuk plotëson një nga pozicionet në listën e çmimeve , tenderi duhet ë refuzohet. Po ashtu kam sqaruare dhe pretendimin ankimorë të nenin 10, qasja në dokumente. Është një shkresë e shkruar me dorë të lirë e nënshkruar nga përfaqësuesit e OE ankues dhe të AK-së, sipas përshkrimit në të përfaqësuesit e OE ankues potencohet se qasja i është lejuar vetëm tek formulari C dhe tek paramasat. Për njëjtën situatë neni 7, të UOPP-së, dhe si sekrete afariste mund të konsiderohen kërkesat e dalura me nenin 68 dhe 69, të LPP-së, e jo edhe pjesë tjera të ofertës".

Anëtari i panelit pyeti përfaqësuesin e AK se lidhur me pikën 7, vendosje të numrit, qfar ka shënuar OE i rekomanduar në atë pikë. Në përgjigje përfaqësuesi i AK-së, z. Fazliu deklaroj: "Ajo është pjesë për vendosje të numrit të lotit – pjesës së tenderit, mirëpo ky tender nuk ka qenë i ndarë në pjesë dhe aj shënim nuk është relevant".

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE:"Ekoinvest" z.Rrecaj deklaroj: "I propozojmë panelit që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në Ri vlerësim dhe mbështesim në tërësi rekomandimet e ekspertit, si dhe kundërshtojmë sqarimet që dha përfaqësuesi i AK-së. Shkeljet e bëra në këtë aktivitet e bëjnë OE të rekomanduar për kontratë të papërgjegjshëm".

Ndërsa përfaqësuesi i AK –KEK z.Fazli në fjalën përfundimtare deklaroj: "As përfaqësuesi i OE ankues as eksperti nuk u thirrën në pikat e neneve që pretendojnë se janë shkelur".

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dosjes së tenderit, shqyrtimit të pikave pretenduese të operatorëve ekonomik ankues, shoshitjes së provave dhe deklaratave te palëve gjate prezantimit të provave në seance, konstatoj se AK / Korporata energjetike e Kosovës, ka rekomanduar për dhënie të kontratës operatori ekonomik "Thyssenkrupp Industrial Solutions AG RT Unit Mining Systems", i cili ka ofertuar në kundërshtim me rregullat e dala me LPP, në fuqi, pasi që formulari C, pjesa e parë e të njëjtit OE, rezulton te jetë e pa vulosur dhe e pa nënshkruar, e që një gjë e tille është e paraparë me dispozitat e nenit 18, paragrafi 3, i rregullave të UOPP-se. Poashtu në të njëjtin formularë i njeti operator ekonomik tek pika 7, ka përshkruar numrin , "1-301-91098", që nuk korespodon me numrin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Po ashtu paneli shqyrtues konstatoi se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës pjesën II, të dosjes së tenderit, paramasa dhe parallogarit , tek pozicionet 3,4 dhe 5 nuk ka ofruar çmim fare, në kundërshtim me rregullat dhe legjislacionin për prokurim publik në fuqi. Për kundër faktit se për të njëjtat pozicione është potencuar se janë të përfshira në pozicionin 1, veprimi i tillë paraqet mos respektim të nenit 39.8, të UOPP-së, si dhe mos respektim të pikës 20.1, të dosjes së tenderit, rrjedhimisht oferta e OE "Thyssenkrupp Industrial Solutions AG RT Unit Mining Systems",kualifikohet si oferte e pa përgjegjshme.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe dëgjimit të palëve në seancën dëgjimore gjeti se AK-KEK me rastin e vlerësimit të ofertave nuk ka vepruar në pajtim me nenin 27,28 dhe 59 të LPP-ës.

Andaj, paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin:117 të LPP-së, dhe atë që u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :
Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur
nuk mund të ushtron ankesë,
por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh,
pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë
kërkesë-padi në Gjykatën Themelore - Prishtinë
Departamenti për Çështje Administrative.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Tefik Sylejmani

REPUBLIKA E KOSOVËS
PANELI I SHQYRTUES I PROKURIMIT
PRISHTINË/A
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
REPUBLIKA KOSOVA